

Blerina KUQI

PROJEKTET PËR KRIJIMIN E KISHËS UNIATE NË SHQIPËRI GJATË PUSHTIMIT ITALIAN

Uniatizmi përfaqëson një përpjekje të Kishës Katolike Romane për të rikthyer në gjirin e saj ata që i quan “të larguarit”. Bëhet fjalë për besimtarët ortodoksë të Kishës Ortodokse Lindore. Selia e Shenjtë, detyrën e prozelizimit dhe të ungjillëzimit në pjesën qendrore dhe jugore të Shqipërisë, ua ngarkoi, fillimisht, murgjve bazilianë të Abacisë së Grottaferrata-s, pranë Romës. Origjina e tyre ishte nga Lindja, prandaj nga pikëpamja kanonike e ruajtën ritin dhe traditën e manastireve bizantine. Pas skizmës së parë [ndarjes] së katolikëve me ortodoksët, në vitin 1054, ata mbetën të bashkuar me Kishën e Romës. Në këtë drejtim, misioni i tyre për të kthyer në gjirin e kishës katolike latine, shqiptarët ortodoksë ishte më i lehtë. Me ta i bashkonte edhe tradita liturgjike greko-bizantine¹.

Në Shqipëri, hapat e para, në këtë drejtim, u hodhën në fundin e viteve 20-të, kur u ndërtua famullia e murgjve bazilianë të Grottaferrata-s, në Elbasan, e cila u drejtua nga prifti unit, Pietro Scarpelli (Pietro Skarpeli), i ardhur nga Kalabria. Atje ishte formuar një bërthamë e vogël ortodoksësh të konvertuar apo simpatizantë të katolicizmit². Ata vepruan në një territor, ku të krishterët ishin ortodoksë dhe i shihnin si kërcënim për besimin e tyre. Pavarësisht pengesave të brendshme të autoriteteve lokale, rezistencës së kishës ortodokse shqiptare e të besimtarëve të saj, prifti unit Pietro Scarpelli, arriti, më 3 tetor 1937, të bëhet arkimandrit me të drejtat e një ipeshkvi. Ai fitoi statusin e një abati me mitër [kapele fetare] dhe në ceremoninë kishtarë të zhvilluar me këtë rast morën pjesë

¹ Giovanni Cimbalo, *Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetare në Shqipëri*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 55.

² Hasan Bello, *Shqipëria Kisha Katolike dhe Vatikani (nga fundi i shek. XIX-1939)*, Tiranë: Onufri, 2019, f. 223.

përfaqësues të lartë të klerit katolik shqiptar si: argjipeshkvi i Shkodrës Gaspër Thaçi e sekretari i tij, Tom Laca, sekretari i Nuncit Apostolik si dhe Mark Harapi S.J. si përfaqësues i jezuitëve³.

Në vëmendjen e katolikëve ishin edhe ata ortodoksë që gjendeshin në zona ku ata përbënin një minorancë siç ishte argjipeshkvia e Shkodrës. Duheshin gjetur rrugët dhe mënyrat për t'i afruar. Delegati Apostolik Leone Giovanni Batista Nigris, që kishte ardhur në Shqipëri që në vitin 1938, i kërkoi, në mars 1939, argjipeshkvit Gaspër Thaçi, të raportonte për numrin e ortodoksëve në dioqezën e tij, ç'mund të bëhej për t'i kthyer në uniatë, si dhe çfarë ishte bërë në të shkuarën në këtë drejtim. Në përgjigjen e tij, ai shkruante se, në Shkodër kishte një grup familjesh ortodokse, që banonin në Vrakë dhe se me ta kishte qenë e pamundur të vendoseshin kontakte direkte. Nga ana fetare ata ishin të lidhur me Patrikanën Serbe. Ai propozonte zgjedhjen e ndonjë personi të aftë, katolik, që të interesohej për ta e të krijonte lidhje dhe për të nxitur më tej bashkëpunimin, në raste konferencash fetare-kulturore, duhej të ftoheshin edhe ata. Sipas tij, vetëm kështu mund të vendoseshin ura ndërlidhjeje. Në lidhje me këtë çështje, si dhe konvertimin e myslimanëve, ai shtonte se po bënte një studim të veçantë, në bashkëpunim me jezuitët, të cilin shumë shpejt do t'ia dërgonte Propagandës Fide⁴.

Siç duket dhe nga ky shkëmbim shkresash mes tyre, procesi i kthimit të ortodoksëve në uniatizëm ishte një pikësynim i qartë. Vështirësia qëndronte tek mënyra sesi do të realizohej kjo. Në praktikë punët vështirësoheshin. Ortodoksët bënin rezistencë dhe e ruanin fort besimin dhe praktikën e tyre kishtarë. Objektivat që kishin vendosur katolikët, tregonin se synimet e tyre ishin jo shumë realiste, pasi shpresonin edhe në një konvertim të myslimanëve. Pikërisht në zonën e Shkodrës, rivaliteti fetar ishte i dukshëm dhe i njohur nga të gjithë e kjo nuk do të ishte një punë e lehtë.

Të interesuar për të marrë përsipër këtë mision ishin dhe françeskanët, por mes tyre dhe Delegati Apostolik pati qejfmbetje. Ata u ndjenë të fyer, kur nuk iu besua detyra e misionimit në Shqipërinë e Jugut. Sipas tyre, Nigris, nuk kishte kompetenca për të caktuar urdhrat e tjerë, pasi ajo krahinë varej nga argjipeshkvia e Durrësit dhe i takonte imzot

³ Markus W. E. Peters, *Përballjet e historisë së kishës katolike në Shqipëri 1919-1996*, Tiranë: Qendra Botuese Shoqata Jezuite, 2010, f. 107-108.

⁴Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej AQSH), (Fondi më tej: F.), 132/A (Viti më tej: V.) 1939, (Dosja më tej: D.) D. 31, (Fleta më tej: fl.) 1.

Pjetër Gjurës, ky vendim⁵. Drejtuesi i tyre, Provinciali at Ciprian Nika, i dërgoi kardinalit Eugène Tisserant (Eugen Tiserant), një promemorie rreth gjendjes në Shqipërinë e Jugut. Ai ishte në krye të Kongregatës së Shenjtë Pro Ecclesia Orientali (Kongregacioni për Kishat Orientale), e cila ishte krijuar që në vitin 1917, falë iniciativës dhe këmbënguljes së Papa Benediktit XV. Veprimtaria e saj u përqendrua në çështjet që kishin të bënin me ritet lindore, duke ia hequr këtë kompetencë Propagandës Fide⁶. Ajo u kujdes që në ato vende ku kishte ortodoksë, të punohej për t'i kthyer në gjirin e kishës romake latine dhe i kushtoi vëmendje të veçantë çdo projekti që sugjeronte rrugë e mënyra drejt arritjes së synimit të vendosur. Provinciali në këtë promemorie, sugjeronte se françeskanët ishin të përshtatshëm për ta kryer këtë mision, pasi kuadrot e tyre ishin shqiptarë dhe do të pranoheshin më lehtë nga popullsia. Si rrugë për realizimin e objektivit përcaktonte, së pari veprimtarinë kulturore⁷.

Përgjigjja që erdhi nga Vatikani, nuk i kënaqi shumë ata, pasi nxirrte në pah disa probleme që ekzistonin e nuk ishin aq të lehta për t'u zgjidhur. Për zonën e jugut, si plan fetar, Kongregacioni kishte përcaktuar: “kujdesim në ndihmën shpirtërore për 1000 katolikët që banojnë atje dhe përfitim nga ky rast bazë për një hov të fuqishëm për të fituar në gjirin e kishës 200.000 skizmatikë dhe 400.000 myslimanë”. Për realizimin e tij, ai konstatonte disa vështirësi, duke filluar që nga mungesat në kuadrin misionar. Në Shqipëri, nënshtetësia e misionarit ishte pengesë në veprimtarinë e tij, pasi të huajt shiheshin me dyshim nga popullsia. Në këtë pikë, Selia e Shenjtë nuk ishte kundër përdorimit të elementit klerik vendas. Bashkëpunimi me fetërit françeskanë u konsiderua jo vetëm i pëlqyeshëm, por edhe i dëshirueshëm, për shkak të besimit të madh që gëzonin në popull. Pavarësisht konsideratave ndaj tyre, kardinali Tisserant nuk ngurroi të theksonte se Kongregacioni i Shenjtë, nuk mund t'ua besonte atyre detyrën për gjithë Shqipërinë e Jugut⁸.

Si arsye kryesore për këtë përgjigje negative u theksua mungesa në kuadër, pengesë kjo që ishte pranuar dhe nga vetë françeskanët. Një problem tjetër që u ngrit ishte forma e apostolimit. Meqë ajo do t'i drejtohej masës ortodokse duhej t'i përshtatej kërkesave të saj. Misionari duhej të bëhej një me të krishterët, të qëndronte pranë tyre e të punonte që t'i kthente në katolikë, jo thjesht në ortodoksë të ritit latin. Pra, qëllimi që

⁵ M. W. E. Peters, *Përballjet e historisë së kishës...*, f. 111.

⁶ G. Cimbalo, *Pluralizmi i besimit...*, f. 70.

⁷ A QSH, F. 133, V. 1939, D. 160, fl. 13

⁸ Po aty.

kishte shpallur Papa Piu XI ishte katolizim dhe jo latinizim e kjo duhej mbajtur fort parasysh. Provincialit Nika, iu sugjerua që të inkurajoheshin disa etër françeskanë për t'u përgatitur në praktikën e ritit bizantin⁹. Mënyra që propozonin françeskanët, për misionimin e masave ortodokse, përmes veprimtarisë kulturore u konsiderua efikase deri në njëfarë pike. Kongregacioni për Kishat Orientale nuk ishte kundër organizimit të konferencave kulturore dhe theksimit të ndjenjave kombëtare, por mendonte se kjo mund të shërbente vetëm si një nxitje fillestare për të shkuar drejt Kishës Katolike dhe nuk duhej mbivlerësuar. Ai theksonte se françeskanët mund të fillonin punën, fillimisht, aty ku kishte më shumë nevojë p.sh. në Gjirokastër ku nuk kishte ende asnjë misionar katolik. Me kalimin e kohës dhe shtimin e numrit të etërve, mund t'u besoheshin edhe detyra më të gjera¹⁰.

Për Selinë e Shenjtë ishte e qartë se kthimi i ortodoksëve në ritin latin nuk ishte një mision i lehtë dhe më parë duheshin plotësuar disa kushte. Që ky proces të ecte më shpejt, ajo këmbëngulte se këtyre besimtarëve duhej t'u krijoheshin besimi se primare ishte kthimi në gjirin e Kishës Katolike Romake dhe jo latinizimi i tyre. Në këtë kohë marrëdhëniet e saj me Italinë nuk ishin aq të mira dhe rreth çështjes së uniatizmit, nuk ndanin të njëjtat qëllime. Për Selinë e Shenjtë ata do të shikoheshin si katolikë dhe që po riktheheshin në gjirin e saj, kurse Italia do ta shfrytëzonte si një mundësi për të rritur ndikimin në zonat jugore të Shqipërisë. Kongregacioni për Kishat Orientale vlerësoi se për momentin, në këtë periudhë, nuk ishin pjekur si duhet kushtet dhe për më tepër nuk shikoheshin françeskanët si të duhurit për ta realizuar këtë projekt. Ndonëse, dhanë si arsye kryesore mungesën e një personeli klerikal të përgatitur për këtë qëllim, kjo nuk ishte e gjitha. Megjithëse françeskanët ishin të gatshëm të dërgonin disa etër për t'u përgatitur në ritin latin, hezitimi ndaj tyre mund të ishte për faktin se meqë personeli ishte shqiptar do të ishte e vështirë të vendoseshin nën kontroll. Ata njiheshin si një urdhër me një tendencë të fortë nacionaliste e prirje kundërshtuese, të cilën e manifestuan edhe në përplasjet që patën me Delegatin Apostolik, përfaqësues i Selisë së Shenjtë. Urdhri françeskan, me kuadrot e tij që mbulonin zonën e veriut të Shqipërisë, nuk mund të realizonte synimin ambicioz e paksa të ekzagjeruar të vendosur nga Vatikani, për të fituar në gjirin e kishës katolike romake 200.000 skizmatikë e 400.000 myslimanë. Në këtë kohë edhe marrëdhëniet e tyre me pushtuesit italianë nuk ishin të

⁹Po aty.

¹⁰Po aty.

mira. Duke vlerësuar realisht kushtet e vështirësitë, si edhe për të shmangur ndërlikime të mëtejshme me Italinë, mbase këto arsye ndikuan në përgjigjen negative të Vatikanit.

Në organin e tyre “Zani i Shna Ndout” e përkohshme fetare-kulturale, përveç “Hyllit të Dritës”, françeskanët filluan botimin e një serie artikujsh, nga janari deri në shtator 1939, të titulluar “Vllazent t’onë Ortodoks të dam prej Rromës”¹¹. Që në numrin e parë u shpall se qëllimi i tyre nuk kishte të bënte me arsye politike, aq më pak të fyente ortodoksët. Ai do të ishte një studim për “me na i çilë sytë e ma kjartas të shohim, na të krishtenët e Ballkanit e sidomos na të Shqypnis, damin e madh, qi i ka sjellë Kishës e ne t’damit nder vedi”. Përmes tyre do të tregonin edhe “dobinë e madhe që do të kishin shqiptarët po të bashkoheshin”. Në artikuj u trajtua dhe historia e ndarjes së krishterimit në dy qendra, Roma e Orienti [Kostandinopoja], që “sot duken si dy pole të kundërta, por dikur të njëjta porsì gjymtyrët e të njëjtit trup”¹².

Françeskanët u shmangën në mënyrë diplomatike, nga misioni i rëndësishëm në jug të vendit. Italia synonte që të rriste sa më shumë ndikimin e vet në një zonë ku bashkëjetonin myslimanët e ortodoksët, të cilët aty ishin me shumicë. Një personel klerik italian ishte më i përshtatshëm. Ata nuk mund të lejonin që ky urdhër, në përbërje të të cilit kishte vetëm elementë vendas shqiptarë, të merrte përsipër një punë të tillë. Delegati Apostolik, Nigris i shfaqti shqetësimin e tij Mëkëmbësit Jacomoni, në letrën që i dërgoi në prill 1939. Nga informatat që i vinin atij, fillimisht, nga Vlora, dukej se ekzistonte gatishmëria mes ortodoksëve drejt uniatizimit. Sipas tij, tashmë ky proces kishte ndaluar, pasi ishin përhapur fjalë se “situata ishte transitore dhe do të kthehej si më parë, falë qëndrimit dhe ndërhyrjes së Anglisë dhe Francës”. Të gjithë ata që dëshironin të ktheheshin në uniatë, theksonte ai, ishin “të preokupuar për gjendjen e tyre, nëse kjo do të ndodhte”. Në fund të letrës, në formën e një pyetjeje ai shprehte dhe mendimin e tij se “kush mund të ishte prapa gjithë kësaj, se mos është në këtë mes dora e Greqisë përmes konsullit të saj?”¹³ Natyrisht që Greqia ndiqte me kujdes çdo gjë që ndodhte në jugun ortodoks të Shqipërisë. Ajo nuk do ta pranonte me aq lehtësi një kalim masiv nën kishën romake. Besimi i përbashkët që i bashkonte me ortodoksët e Shqipërisë, vinte nga një traditë shekullore, e vështirë për t’u

¹¹ “Vllazent t’onë Ortodoks të dam prej Rromës”, *Zani i Shna Ndout*, Nr. 1-9, Shkodër, janar-shtator 1939, f.37.

¹²*Po aty*.

¹³*AQSH*, F. 161, V. 1939, D. 729, fl. 4.

braktisur sa hap e mbyll sytë. Hezitimi i ortodoksëve në Vlorë, përveç propagandës së mundshme të Greqisë, kishte dhe shkaqe që lidheshin me situatën e brendshme. Bashkimi i kishave do ta rriste ndikimin e italianëve që i konsideronin pushtues, prandaj dhe i bënë rezistencë të fortë procesit. Autoritetet italiane e shikonin uniatizmin si një mjet për shtrirjen e influencës në jug të vendit aty ku dhe ndikimi i Greqisë, përmes fesë, ishte më i madh. Në planet e saj pushtuese, Ballkani ishte një pikë kyçe dhe shpresonin të gjenin një mbështetje të gjerë nga ana e ortodoksëve shqiptarë. Bashkimi i dy kishave do të ndryshonte dhe raportin e popullsisë nga ana fetare. Italianët mendonin se tek të krishterët do të gjente një aleat të natyrshëm.

Rëndësi merrte qëndrimi i strukturave drejtuese të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare (KOASH), në mënyrë të veçantë, kryepeshkopit Kristofor Kissi. Mëkëmbësi Jacomoni, në gusht 1939, zhvilloi një bisedë të posaçme me të. Sipas tij, Kissi kishte shprehur dëshirën për t'u bashkuar me kishën romake, se ky nuk ishte vetëm një mendim i tij personal, por edhe i masës së besimtarëve, "të cilët nuk do të kundërshtonin nëse Sinodi i Shenjtë do të merrte zyrtarisht një vendim të tillë". Ai shtonte se Kissi, madje, kishte thënë se uniatizmi nuk ishte realizuar deri më tani pasi kishin munguar kushtet politike për ta realizuar atë, se gjithashtu, "për shqiptarët ortodoksë, kjo do të ishte dhe një zgjidhje e mirë duke shpëtuar nga ndikimet ballkanike e sidomos ato greke". Tani ishin pjekur kushtet e nevojshme që të diskutohej jo më me Vatikanin, por me Italinë, e cila do të jepte dhe garanci financiare më të mira¹⁴.

Jacomoni në fjalët e tij është i njëanshëm dhe del qartë imponimi italian rreth çështjes së uniatizmit. Nuk jemi të sigurt nëse kryepeshkopi Kissi u shpreh hapur në favor të saj. I gjendur në një diskutim të tillë ku duhej të maste me kujdes çdo fjalë që do të thoshte dhe përballë funksionarit më të lartë, i cili përfaqësonte Mbretin Vittorio Emanuele III, duket se ai e ka shmangur me takt atë, duke ia lënë në dorë vendimin Sinodit të Shenjtë. Mungesa e kushteve politike ishte më shumë një mënyrë e Jacomonit për të treguar se tani vetëm Italia mund ta realizonte këtë iniciativë pa qenë nevoja të diskutohej me Vatikanin. Për kryepeshkopin ishin ende të freskëta, përpjekjet për të fituar Tomosin e autoqefalisë nga Patrikana e Stambollit. Kishin kaluar vetëm dy vjet nga fitimi i saj dhe mbështetja e shtetit kishte qenë një nga faktorët

¹⁴ Roberto Morozzo della Rocca, *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, Tiranë: Elena Gjika, 1994, f. 214.

vendimtarë, pa të cilën nuk do t'ia kishin dalë. I ndodhur para një situatë ku e kishte gati të pamundur të jepte një përgjigje negative, ai pranoi që këtë çështje ta shtronte për diskutim në Sinodin e Shenjtë.

Autori Roberto Morozzo della Rocca, në librin e tij na sjell një informacion që Jacomoni, në shtator 1939, ia kishte dërguar Nënsekretariatit për Punët Shqiptare, në Ministrinë e Jashtme të Italisë. Sipas tij, mes anëtarëve të Sinodit të Shenjtë nuk kishte një unitet mendimi dhe ishin krijuar dy rryma. Në të parën bënë pjesë kryepeshkopi Kristofor Kissi, mitropoliti i Beratit Agathangjel Çamçe dhe mitrofori Vasil Marku, të cilët ishin në favor të uniatizmit. Në tjetrën ishin mitropoliti i Korçës, Evllogjio dhe ai i Gjirokastrës Pandelejmoni, të cilët kërkonin ruajtjen e status quo-së¹⁵. Gjithashtu, Jacomoni propozonte që shpallja e uniatizmit të shoqërohej me një deklaratë mbi organizimin e ardhshëm të kishës, në mënyrë që t'i sigurohej klerit një mirëqenie më e mirë materiale. Sipas sugjerimeve edhe nga ana e kryepeshkopit, mbështetja financiare mendohej të kapte shifrën e 450.000 franga shqiptare. E konvertuar në monedhën italiane, ishte 2.812.500 lireta, shifër kjo tepër e lartë për financat shtetërore. Subvencionet, që ishin parashikuar për ta, pasi të kalonin në uniatizëm nuk ishin më shumë se 850.000 lireta, shifër kjo pak më e lartë se sa merrte KOASH në ato momente¹⁶.

Raportimet që Mëkëmbësi i dërgonte Romës e paraqitnin situatën rozë, por ai nuk kishte parashikuar se shifra që do të kërkohej do të ishte e papërbalueshme. Procesi u ndal nga ata që ishin më shumë të interesuar, Italia dhe Vatikani. Studiuesi Della Rocca, që ka hulumtuar dokumentet italiane të kohës, sjell këto arsye: së pari, Roma ngurroi pasi ishte e shqetësuar nga reagimet që do të kishin fqinjët ballkanikë, Jugosllavia dhe Greqia; së dyti, vetë Selia e Shenjtë refuzoi nënshkrimin e marrëveshjes, mbasi në gjirin e saj kishte mendime të kundërta. Në Kongregacionin për Kishat Lindore, një pjesë mendonte se bashkimi duhej bërë në mënyrë të shkallëzuar e gradualisht. Sipas tyre, niveli i klerit ortodoks shqiptar ishte shumë i ulët dhe duhej punuar shumë në këtë drejtim. Pjesa tjetër, në mes të së cilës ishte dhe kardinali Tisserant, ishte për një bashkim të menjëhershëm e më pas të punohej për ngritjen e formimin fetar të priftërinjve, përmes seminareve e disiplinës së fortë¹⁷.

Autori Markus W. E. Peters, për këtë moment, shprehet se

¹⁵Po aty, 215.

¹⁶Po aty.

¹⁷Po aty, 216.

“Vatikani humbi një shans historik”. Sipas tij, mentaliteti i popullit shqiptar, ishte i tillë që “në momentin që drejtuesi i Kishës Ortodokse Shqiptare do të vendoste bashkimin me Romën, të gjithë besimtarët do ta ndiqnin pas”¹⁸. Në të vërtetë ky pohim nuk i përgjigjet realitetit shqiptar. Uniatizmi ishte një temë shumë e diskutueshme. Përpjekjet për t’i kthyer ortodoksët në uniatë kishin filluar që në vitet 20-të, por pa sukses. Prandaj edhe në këto momente nuk ishte dhe aq e sigurt se masa e besimtarëve do ta ndiqte kryepeshkopin si një tufë e bindur. Nga ana tjetër, Vatikani, nuk mund të lejonte që autoritetet italiane të përziheshin në këtë çështje. Marrëdhëniet e tij me qeverinë italiane, nuk ishin më të mirat e të dyja palët kishin rezerva për njëri-tjetrin.

Në pamje të parë, u duk sikur kryepeshkopi i pranoi propozimet italiane. I imponuar dhe i detyruar nga rrethanat e kohës ai zgjodhi të rrezikonte. U kërkoi një shumë që ishte i bindur se nuk mund ta përballonin. Në rast të kundërt, do të fitonte më shumë se ç’mund të kishte shpresuar. Italia ishte e përfshirë në një luftë botërore e ambiciet e saj të mëdha kërkonin mjete financiare për t’u realizuar dhe kërkesat shqiptare ishin tej mundësive. Duke analizuar veprimet e tij, mendojmë se ai pranoi të hynte në bisedime për të shmangur konfliktet me italianët, duke shpresuar në zvarritjen apo mos realizimin e projektit italian për krijimin e një kisha uniate në Shqipëri.

Në këtë kontekst, u hoq dorë nga bashkimi i kishave, pasi u vlerësuan për momentin pro-të dhe kundër-t nga të gjitha palët e përfshira, por Selia e Shenjtë, nuk u dorëzua në objektivin e saj. Thjesht zgjodhi një rrugë tjetër për ta realizuar atë. Kisha Katolike, bëri një ndryshim nga pikëpamja organizative. Territori që administrohej prej saj u nda në dy zona: veriore dhe jugore. Zona e parë, veriore, ruajti organizimin e mëparshëm dioqezan, me 2 argjipeshkvi: atë të Shkodrës e të Durrësit, 3 ipeshkvi ajo e Pultit, Sapës dhe Lezhës dhe me abacinë e Oroshit, në Mirditë dhe vazhdonte të ishte nën varësinë e Kongregatës së Shenjtë Propaganda Fide. Në zonën e dytë, në jug të Shqipërisë, u ngrit Administrata Apostolike për Shqipërinë Jugore, më 11 nëntor 1939, nga Papa Piu XII. Në të bënin pjesë Gjirokastra, Berati, Korça, Elbasani dhe Vlora. Ajo ishte nën juridiksionin dhe varësinë e Kongregatës së Shenjtë Pro Ecclesia Orientali [Kongregacioni për Kishat Orientale] dhe nën drejtimin e Delegatit Apostolik në Shqipëri, Nigris¹⁹.

¹⁸M. W. E. Peters, *Përballjet e historisë së kishës...*, f. 120.

¹⁹G. Cimbalo, *Pluralizmi i besimit...*, f. 70, 82; “Ngrëhja e Administratës Apostolike të Jugut”, *Kumbona e së Diellës*, Nr.2, Shkodër, shkurt 1940, f. 31.

Në korrespondencën që Nigris pati me Mëkëmbësin Jacomoni i shpjegonte se kjo masë e marrë nga Selia e Shenjtë kishte për qëllim lehtësimin e punës misionare tek vendasit dhe asistencën fetare për italianët që ishin aktualisht në Shqipëri, si dhe për ata që do të vinin në të ardhmen. Për të, ky nuk ishte një organizim i ri po të mbahej parasysh bashkimi i ortodoksëve me Romën²⁰. Pra llogaritej, që në të ardhmen të arrihej një unifikim i të krishterëve dhe kështu kisha do të ishte më kompakte nga pikëpamja administrative-territoriale. Qëllimi final ishte të mos ekzistonin më termat *veriu katolik* dhe *jugu ortodoks*. Në të vërtetë realizimi praktik i tij rezultoi një punë e pamundur.

Selia e Shenjtë vazhdoi përpjekjet për kthimin në gjirin e saj të ortodoksëve nëpërmjet dërgimit të misionarëve, të cilët do të krijonin një urë lidhëse me ta. Ky do të ishte një hap i parë dhe do të krijonte një terren të përshtatshëm për më vonë. Kështu, në Shqipërinë e Jugut: në Vlorë, Berat, Himarë, Sarandë e Korçë u vendos të ndërtoheshin disa famulli dhe një numër institucionesh bamirëse. Gjatë vitit 1939 zbritën në Durrës 58 priftërinj katolikë, që u shpërndanë në to²¹. Puna e tyre kishte të bënte me bindjen e ortodoksëve për t'iu bashkuar Kishës Katolike Romake. Atyre nuk do t'u ndërroheshin zakonet kishtare si pagëzimi, kurorëzimi, varrimi etj., të cilat do t'i kishin të njëjta me kishën ortodokse. Ndryshimi konsistonte në faktin se gjatë meshës prifti uniat do të përmendte emrin e papës dhe peshkopin e peshkopatës, që për jugun e Shqipërisë ishte Delegati Apostolik. Ai që dëshironte të kthehej në uniat nënshkruante një deklaratë dhe në fund betohej mbi ungjill se do t'i qëndronin besnik asaj²². Po sjellim një të tillë të firmosur, më 28 nëntor 1939, në Shkodër²³. Nga hulumtimi i dokumenteve arkivorë, në fondin e argjipeshkvisë së Shkodrës kemi gjetur disa prej tyre. Për të kuptuar realisht numrin e uniatëve, filloi puna për mbledhjen e të dhënave nga qytete të ndryshme të Shqipërisë së Jugut. Në shkurt 1940, Drejtorisë Mbretërore të Policisë, nga burime

²⁰AQSH, F. 161, V. 1940, D. 392, fl. 6.

²¹Rakip Beqaj, *Veprimtaria antikombëtare e klerit katolik shqiptar*, Tiranë: Naim Frashëri, 1969, f. 139.

²²Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri (sipas burimeve arkivore)*. Ribotim, Tiranë: Botimet "Trifon Xhagjika", 2014, f. 139.

²³AQSH, F. 132/A, V. 1939, D. 40, fl. 3. "Unë e nënshkruemja Kristina e bija e Ndin Ndreçkës, le në Berat (lagja Vrjoni) në vjetin 1920, me kuptim të plotë të mendes e me liri të plotë të vullndesës po kaloj prej orthodoksijet në prehen të Kishës Katholike, tuj pranue gjithçka beson e mëson Shejtja Amë Kishë Katholike e Romës tuj njoftë për kryetar të Kishës së vërtetë themelue prej Jezu Krishtit Zotit t'onë, Papën e Romës. Në dishmi po me dorën t'eme Kristina e Ndin Ndreçkës".

konfidenciale i erdhën informata se në Tiranë, Vlorë, Korçë, Shkodër e Gjirokastrë “bashkimi i kishave shikohej me sy të mirë” e kjo “do të zhdukte mjetin kryesor të propagandës greke dhe do të krijonte një numër të madh qytetarësh nën influencën e Romës, duke balancuar masën myslimane që favorizonte panislamizmin”. Aty, sugjerohej që autoritetet ta studionin mirë situatën, si dhe mundësinë që të ndërhyhej me shumë takt dhe kujdes “duke u mbështetur tek personat e duhur që nuk bien në sy dhe nuk i ekspozojnë organet shtetërore”. U kërkua gjithashtu, që drejtoritë e policisë së këtyre qyteteve të jepnin informacione të detajuara për këtë çështje²⁴.

Nga Gjirokastra raportohej se duhej shfrytëzuar gjendja e elementit ortodoks, i cili ndihej i lënë mënjanë për sa i përket shkollimit fetar dhe kjo “injorancë është në favor të bashkimit”. Sipas autoriteteve, menjëherë sapo u shpjegoheshin dallimet e pakta që kishin nga ana historike e dogmatike, dy kishat, “ata lehtësisht pranonin idenë e bashkimit - shtonin më pas se - më e vështirë ishte me intelektualët”, në pjesën më të madhe të influencuar nga shkollimi i tyre në Greqi. Ata shfaqnin simpati për seriozitetin e ritit katolik, por nuk prononcoheshin. Të dy peshkopët antiunionistë, qëndrim të cilin e kishin mbajtur që në fillim, Pandelejmon Kotoko i Gjirokastrës dhe Evllogji Kurilla i Korçës cilësoheshin si grekofilë²⁵.

Sipas raportimeve, në Shkodër, ku katolikët kishin qendrën e tyre kryesore, thuhej se “uniatizmi dëshirohej nga të gjithë dhe shikohej si një mënyrë për t’i bërë ballë e për të balancuar masën myslimane”. Por, në realitet, ortodoksët të pasigurt rreth zhvillimeve të politikës italiane, në Shqipëri, preferonin të qëndronin në pritje duke u treguar shumë të kujdesshëm e të matur. Në Tiranë u evidentua prifti Dinko Matoff, i lindur në Strugë, si një element i rrezikshëm nga pikëpamja politike dhe kundërshtar i bashkimit. Edhe në Vlorë, ndonëse projekti i bashkimit kishte filluar dy vjet më parë nga prifti italo-shqiptar Pjetër Skarpeli, i cili u zhvendos nga Elbasani drejt Vlorës, nuk shikohej me sy të mirë. Sipas listave të policisë, në këtë qytet katolikë ishin: 44 shqiptarë dhe 300 italianë; uniatë rreth 200; ortodoksë 2967; izrealitë 71 dhe myslimanë 5726. Në Korçë, raportet ishin edhe më “entuziaste” pasi jo vetëm që dëshirohej bashkimi, por “ortodoksët luteshin” që kjo të ndodhte.²⁶

²⁴ *AQSH*, F. 153, V. 1940, D. 101, fl. 1.

²⁵ *Po aty*, fl. 3.

²⁶ *Po aty*, fl.4-7.

Nga analiza e dokumenteve shihet se informacionet që jepnin autoritetet lokale e paraqitnin gjendjen në mënyrë të zbukuruar, sipas asaj që donin të dëgjonin eprorët lart. Raportohej vetëm për dëshirën e ortodoksëve për t'u kthyer në uniatë, ndërkohë që kuptojmë se rezistencë më të madhe ndaj uniatizmit bënin elitat intelektuale të shkolluara që shikonin përtej asaj që trumbetohej. Si mbështetje mendohej se do të ishin masat e besimtarëve të thjeshtë, duke shfrytëzuar jo vetëm paditurinë e tyre, por edhe varfërinë. Për autoritetet ishte e qartë se për sa i përket propagandës ajo duhej të ishte e kujdesshme dhe e matur, që të afroreshin më lehtë, por njëkohësisht duke evidentuar e mbajtur nën vëzhgim personat që ishin kundër.

Shpresat e françeskanëve, për misionim në jug, u shuan kur sekretari i Kongregacionit për Kishën Lindore, kardinali Tisserant, i shkruante, në shkurt 1940, drejtuesit të Urdhrit Françeskan se do të krijohesh një degë e ritit lindor, në Shqipëri. Kjo praktikë kishte rezultuar e suksesshme edhe në Bullgari. Murgjit e parë françeskanë të ritit lindor erdhën, në korrik, nga Provinca e Padovës dhe krijuan misione në Lushnjë, Berat, Vlorë, Dhërmi, Vuno. Dy misionet në Delvinë dhe Porto Edda (Sarandë) mbetën vakante deri në fund të luftës. Këmbëngulja e madhe, që me këtë detyrë të merreshin misionarë shqiptarë dhe jo të huaj, për t'i fituar më lehtë ortodoksët, rezultoi pa dobi²⁷. Përveç tyre dhe murgjve bazilianë të Grottaferatës, erdhën dhe etërit viçencinë nga provinca romane²⁸.

Rreth numrit të atyre që u kthyen në uniatë nuk disponojmë një statistikë të plotë. Nga të dhënat e paraqitura më lart, sipas raportimeve, numri i uniatëve në Vlorë ishte rreth 200 veta. Në shifra më të ulëta ishin edhe në zonën e Korçës. Atje që prej vitit 1931 vepronte misioni katolik i drejtuar nga padre Francesco Tommaso Bruneti (Françesko Tomaso Bruneti), që kishte si detyrë asistencën fetare për katolikët e zonës. Veprimtaria e tij u zhvillua më tej, derisa në vitin 1938, me ndihmën edhe të bamirësve të ndryshëm, ai arriti të blinte një rezidencë që u transformua në kishë. Në të u kryen shërbesa fetare si për katolikët ashtu edhe për uniatët e parë. Numri i tyre erdhi duke u shtuar nga dita në ditë, deri sa në vitin 1940, u krijua një komunitet i vogël prej 130 vetash. Nga kjo zonë filloi dhe rekrutimi i vendasve si për klerikë ashtu edhe për murgesha²⁹. Për autorin Markus W. E. Peters, deri në gjysmën e parë të viteve 40 ishin

²⁷ M. W. E. Peters, *Përballjet e historisë së kishës...*, f. 124-125.

²⁸G. Cimbalo, *Pluralizmi i besimit...*, f. 83.

²⁹AQSH, F. 132, V. 1942, D. 33, fl. 1-2.

4.400 katolikë që iu bashkuan kishës së Romës. Ai mendon se në këtë shifër mund të jenë përfshirë edhe italianët katolikë që u vendosën në jug të Shqipërisë për arsye të ndryshme dhe duke mos disponuar një statistikë të ndarjes së katolikëve të jugut, sipas kombësisë ky numër mund të mos i përgjigjej realitetit³⁰.

Konvertimi eci me ritme të ngadalta. Nuk ishte i lehtë veprimi në një zonë ku tradita ortodokse ishte e fortë dhe misionarët ishin të huaj. Gjithashtu duhen marrë në konsideratë edhe kushtet në të cilat po ndërmerrej kjo iniciativë. Lufta Botërore që kishte shpërthyer ishte një faktor pengues. Pas gati nëntë muajsh, Italia i shpalli luftë Greqisë dhe jugu i Shqipërisë u kthye në një arenë luftimesh. Koha shtronte për zgjidhje probleme më të rëndësishme, një ndër këto ishte edhe mbijetesja.

Mes Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare dhe Kishës Katolike Romane u ruajtën marrëdhënie të mira edhe pse nuk u finalizua një marrëveshje bashkimi. Më 13-16 tetor 1940, u mbajt në Abacinë Baziliane të Grotaferratës, Sinodi i Parë i Orientalëve të ritit bizantin. Në të morën pjesë eparkitë orientale të Lungrit dhe të Piana dei Greci, si dhe një delegacion shqiptar i kishës ortodokse. Në Italinë e Jugut, pas vdekjes së Skënderbeut, pati një valë masive emigrimi të shqiptarëve. Ata i ruajtën gjuhën e zakonet e tyre. Nga pikëpamja kishtarë, së bashku me pjesën tjetër, u lejuan dhe i zhvilluan ceremonitë fetare në ritin grek. Përgjatë shekujve edhe pse kishin autonomi fetare, nga ana e Kishës Katolike u morën disa masa për një administrim më të mirë të tyre. Papa Benedikti XV krijoi, në vitin 1919, në Kalabri, Eparkinë e Lungrit për italo-shqiptarët e ritit bizantin, ndërsa në vitin 1937, Papa Piu XI krijoi eparkinë tjetër në Sicili, në Piana dei Greci. Të dyja vareshin nga Manastiri i Grotaferratës, i cili në këtë kohë mori formën e një Abacie, me qëllim që arbëreshët të drejtoheshin “nga barinjët e vet”³¹.

Delegacioni përbëhej prej personaliteteve të klerit e të parisë ortodokse dhe kryesohej nga peshkopi i Beratit dhe i Vlorës, imzot Agathangjel Çamçe, një personalitet i njohur për patriotizmin dhe shërbimet e tij në KOASH. Anëtarë të tjerë ishin Stavrofor Josif Rehova zëvendëspeshkop i Korçës, Protodhjakon Petro Doçi, Erazmi Jorgo prift i Durrësit, Kristaq Zagurida anëtar i Këshillit të Epërm Fashist Korporativ, inxhinier Vangjel Goxhamani këshilltar në Kishën Ortodokse, Mihal Shani tregtar, Timo Dilo gazetar, Luigi Petrotta (Luixhi Petrotta)

³⁰M. W.E. Peters, *Përballjet e historisë së kishës...*, f. 121.

³¹P. Benedikt Dema, “Sinodi Italo-Shqiptar, *Hylli i Dritës*, Nr. 10-11, Shkodër, tetor-nëntor 1940, f. 479-482.

përkthyes. Delegacioni shprehu dëshirën për t'u takuar me ministrin e Jashtëm Ciano, si dhe për të vizituar disa nga pjesët më të rëndësishme të kryeqytetit si zona monumentale, Vatikanin dhe disa kisha kryesore etj.³²

Sinodi u kryesua nga Kardinali Lavitrano, argjipeshkëv i Palermos dhe Administrator Apostolik i dioqezës së re italo-shqiptare të Piana dei Greci. Ndër anëtarët e tjerë më kryesorët ishin: imzot Mele, ipeshkëv i Lungros për greko-shqiptarët e ritit bizantin, imzot Perniciario i peshkopatës së Piana dei Greci, Arkimandriti i Abacisë së Grataferratës, përfaqësues të tjerë të kishave baziliane të Sicilisë e Kalabrisë si dhe rektorët e Seminarit Papnor të Grataferratës e Shën Bazilit si dhe ai i Kolegjit Papnor Grek, në Romë³³. Në fjalën e hapjes, Kardinali Lavitrano, theksoi se ky Sinod ishte, ndër të tjera, edhe një dëshmi e re e përkujdesjeve të vazhdueshme të kishës romane. Ajo pranoi në gjirin e vet vëllezërit, që u larguan nga Orienti dhe u vendosën në Itali. Sipas tij, “vetëm kështu u ruajt pastërtia e riteve, integriteti i besimit katolik që u kërcënua dhe u persekutua, në fillim nga patriarkët rebelë e më pas nga shpata myslimane”. Më pas, të gjithë të pranishmit, i bënë homazhe e nderuan Papën duke i dërguar dhe një telegram në shenjë nderimi³⁴.

Mes kryepeshkopit Kissi dhe kardinalit u shkëmbyen telegrame, me rastin e fillimit të punimeve³⁵. Diplomati dhe i kujdesshëm, kryepeshkopi vuri në dukje se delegacioni shqiptar thjesht do të asistonte si vrojtues dhe se kjo përpjekje do të shërbente për përforcimin e miqësisë mes popullit italian dhe atij shqiptar. Në shtypin e tyre, “Jeta Kristiane”, ndryshe nga françeskanët që i kushtuan një artikull të gjatë e të detajuar zhvillimit të punimeve të sinodit, kjo ngjarje kaloi thjesht me një njoftim të shkurtër rreth një faqe. Aty u rikonfirmua se, misioni i dërgatës ishte

³²AQSH, F. 161, V. 1940, D. 577, fl. 3-4.

³³AQSH, F. 161, V. 1940, D. 392, fl. 108. Artikulli është marrë nga gazeta italiane *L'Osservatore romano*, 14/15.10.1940, Nr. 118.

³⁴Po aty.

³⁵P. Benedikt Dema, “Sinodi Italo-Shqiptar...”, f. 479. Kardinali Lavitrano i dërgoi këtë telegram “Të përmalluar në një mënyrë të veçantë prej provave që dha simpatija e madhe e juaja nëpërmjet përfaqësimit të shkëlqyem, qi na dërguet, kleri i ynë italo-shqiptar ndiesit miqësore i shndërron me të njajtën dashtni, tue ju falë nderes e tue u lutë qi i madhi Zot të ndigjojë dishiret e përbashkta”; Kryepeshkopi Kisi i ktheu këtë telegram “Ju falemi nderes me zemër për pritjen bujare, qi i batë dërgatës së Kishës s'onë Orthodoxke Autoqefale, e ngarkueme për t'asistue si vrojtse në të parin Sinod të si vëllazenvet t'onë të dashtun përtej Adriatikut. E thashtë Zoti e Shëlbuesi i ynë Jezu Krishti qi kjo përpjekje fatlume shpirtnore, qi përfitoj një kënaqsi aq të këthellë ndër besimtarët t'onë, të përforcjojë përherë e ma tepër miqsin trashëgimtare ndërmjet popujvet t'Italis e të Shqypnis”.

thjesht si dëgjues, pa asnjë të drejtë tjetër dhe se qëllimi i pjesëmarrjes kishte të bënte me vendosjen e kontakteve dhe afrimin me ortodoksët shqiptarë përtej Adriatikut. “Ata -vihej në dukje - duke jetuar në një atmosferë të lirë dhe me përkrahjen gjithnjë të Italisë liberale” zhvilluan gjuhën amtare, pasuruan letërsinë e ruajtën traditat e vjetra të racës shqiptare. Për këtë veprimtari aktive e patriotike ata kishin mirënjohjen dhe falënderimet e ortodoksëve shqiptarë³⁶.

Në pamje të parë duket sikur vendimi për të marrë pjesë në një mbledhje të rëndësishme për çështjen uniate, tregonte interesim të KOASH në lidhje me të. Kushtet e brendshme imponuan pjesëmarrjen e delegacionit në Romë. Presioni italian në mos i shfaqur në mënyrë të hapur, ekzistonte gjithmonë. Në pamundësi për të vendosur lirisht, u bë një kompromis i nevojshëm. E vetmja autonomi që mund të ushtronte Kryepeshkopi Kisi, në këtë rast, ishte mospjesëmarrja në dërgatë. Prania e tij do të krijonte iluzione përtej detit dhe debate në Shqipëri. Pjesa më e madhe e besimtarëve nuk e pranonte idenë e uniatizmit dhe ai nuk do të shihej me sy të mirë prej tyre. Sinodi u interpretua si një mundësi për të rivendosur lidhjet me vëllezërit shqiptarë ortodoksë dhe u ngrit lart roli i Italisë duke lënë pa përmendur Papën apo Vatikanin.

Gjatë qëndrimit të delegacionit në Romë, u realizua dhe takimi me kontin Ciano, në prani dhe të Mëkëmbësit Jacomoni. Sipas tij, prezenca e tyre në Grotaferrata ishte shenjë e një afrimi shpirtëror mes besimeve kristiane. Koha e organizimit të sinodit, në planin ndërkombëtar, për Italinë, koinçidonte me përgatitjet e saj për të sulmuar Greqinë. I rrëmbyer nga entuziazmi, Ciano i drejtohet mitropolitit Çamçe duke u shprehur se, shumë shpejt numri i ortodoksëve në Shqipëri do të rritej. Ai kishte në mendje Çamërinë, një pjesë e popullsisë e së cilës ishte ortodokse. Vetë Jacomoni, në kujtimet e tij thotë se u habit nga fjalët e tij, “që shënonin fundin e parakohshëm të tentativës së bashkimit të dy kishave”³⁷. Italia ndërkohë kishte përpara një sfidë të madhe, e cila ishte më e rëndësishme se uniatizmi. Në një kohë tjetër me kushte të reja mbase mund t’i kushtonte më shumë rëndësi.

Një nga rrjedhojat e mbledhjes së prelatëve të lartë, në Grotaferrata, ishte hapja, në tetor 1940, e një Kolegji Ipeshkvnor në Piana dei Greci. Kjo ishte një iniciativë e karakterit kulturor- fetar e Kardinalit

³⁶ “Dërgata orthodokse në Romë”, *Jeta Kristiane*, Nr. 8, Tiranë, tetor 1940, f. 285.

³⁷ Francesco Jacomoni Di San Savino, *La politica dell’Italia in Albania*, San Casciano: Cappelli Editore, 1965, f. 250.

Lavitrano për italo-shqiptarët. Konvikti u vendos, përkohësisht, në ambientet e famullisë. Kolegji u drejtua nga prifti Papas Giovanni Di Maggio (Papas Xhovani Di Maxhio), me gradën doktor në letërsi, zëvendësrektor i seminarit italo-shqiptar në Palermo. U shpreh dëshira nga ana e kardinalit dhe e klerit të Piana dei Greci që një numri, qoftë minimal, i të rinjve ortodoksë shqiptarë, t'u akordohej bursë në këtë institut. Aty ata do të edukoheshin në ritin bizantin "si prindërit e tyre", mund t'u mësohej edhe pak italisht dhe do të mundeshin që përmes edukimit katolik "të shijonin pak edhe kulturën italiane". Kolegjit mund t'i akordohej dhe një subvencion i mjaftueshëm për të mbajtur me bursë, të paktën, pesë djem ortodoksë shqiptarë. Ata mund të dërgoheshin aty, me rekomandimin qoftë dhe indirekt, të imzot Kissit³⁸.

Hapja e kolegjit tek arbëreshët e Italisë, kishte rëndësi për ta nga pikëpamja fetare se do të ndihmonte në rritjen e numrit të klerikëve vendas. Nga ana tjetër, do të shërbente jo vetëm si një urë lidhëse me përtej Adriatikut, por edhe do të krijonte kushtet e përshtatshme për të përgatitur priftërinjtë uniatë, nga radhët e ortodoksëve shqiptarë, të cilët mund të dërgoheshin pastaj në Shqipëri. Fillimisht, numri i tyre mbase do të ishte minimal, por në të ardhmen duke dhënë bursa mendohej se pjesëmarrja do të ishte më e madhe. Për ta realizuar këtë objektiv po përdorshin lidhjet tradicionale me arbëreshët, duke dëshiruar që të merrnin shembull prej tyre, si dhe duke shpresuar në mbështetjen qoftë edhe indirekte të kryepeshkopit Kissi.

Projektet dhe përpjekjet për krijimin e një kishë uniate në Shqipëri patën intensitetin e tyre më të madh në periudhën e viteve 1939-1940. Bisedimet u lanë në mes, por puna nuk ndaloi. Ajo u zhvillua me ritme më të ngadalta nga misionet e ndryshme, që vepruan në jug të vendit. Veprimtaria e tyre, në plan të parë ishte bamirëse dhe edukative, por pa e larguar vëmendjen nga qëllimi kryesor. Mbase shpresat e kishës katolike ishin të mëdha për misionimin e popullsisë ortodokse, por realiteti ishte krejt ndryshe. Ata ndeshën në rezistencën e besimtarëve për t'iu bashkuar kishës së Romës. Por, nëse nuk u mirëpritën shumë nga ana fetare, fituan simpatinë e vendasve për sa i përket bamirësisë, pasi jetuan e vepruan në të njëjtat kushte të vështira ekonomike si edhe ata. Gjithashtu dhanë një ndihmesë edhe në aspektin mjekësor. Godinat e misioneve të tyre u përdorën për të mjekuar të plagosurit nga lufta³⁹. Megjithatë në total numri i uniatëve mbeti në shifra modeste.

³⁸AQSH, F. 161, V. 1940, D. 392, fl. 88.

³⁹AQSH, F. 132, V. 1942, D. 33, fl. 2.

Blerina KUÇI

SUMMARY

THE PROJECTS FOR THE CREATION OF A UNITARY CHURCH IN ALBANIA DURING THE ITALIAN OCCUPATION

Italy took concrete steps in the project to create a unitary church in Albania, but its practical realization turned out to be more difficult than expected and the Orthodox believers resisted to preserve their faith and religious rites. The Archbishop of the Albanian Autocephalous Orthodox Church, Kristofor Kissi, faced direct pressure from Viceroy Jacomoni to support the project to establish a unitary church in Albania. But he, with a clever tactical move, left the decision in the hands of the Holy Synod, and demanded a sum three times higher than the subsidies he received from the Albanian government.

This amount proved unaffordable for the Italians and this process was stopped by those who were more interested, the Vatican and Italy. At this time, his relations with the Mussolini government were not so good and on the issue of uniatism, they did not share the same goals. For the Holy See, the Uniates would be seen as Catholics returning under its authority, and the Italian government saw it as an opportunity to increase its influence in the southern areas of Albania. However, this movement continued at a slower pace than the various missions that operated in the southern cities of Elbasan, Korça, Berat, Fier, Lushnja, Vlora, Pogradec and Gjirokastra. Catholic missions exercised their activity albeit in time of war. They were important for the medical assistance they provided to the population, for the care of orphaned children, the elderly and the poor. Although their activity was primarily charitable and educational, they did not divert attention from the mission of unification, encountering resistance from Orthodox believers to join the Church of Rome. The results were "modest" and the number of units in the southern part of Albania did not exceed a few hundred.